KMDK
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A.

KMDK.SH.A
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A
KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C
KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD
Nr. 02/2609
Dt. 27/11/2026 Shtojcë 1
Prishtinë

Nr. 461/2026
Datë: 27.11.2026

Duke u bazuar në Nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës; në Nenin 16, pikën 16.3.3 të Statutit të KMDK-së Sh.A të datës 30.05.2025; në Rregullorën Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm, Pagat, Benefitet dhe shtesat në KMDK Sh.A të datës 29.08.2025; Vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. 33/2025 për miratimin e Përshkrimeve të Vendeve të Punës në KMDK Sh.A. i datës 29.08.2025, dhe neni 5, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2024 për Kriteret dhe Procedurat e Punësimit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A., U.D. Kryeshefja Ekzekutive (U.D. KE) e KMDK-së nxjerr këtë:

VENDIM PËR PLOTËSIM/NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.406/2026

- Shtyhet afati i aplikimit për pozitën "Urëmatës/Mbikëqyrës i Sektoreve në DS Velekincë", Gjilan, për pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë, deri më datë 18.12.2026.

I. Obligohet Departamenti për Shërbime Mbështetëse të njoftojë kandidatët e interesuar përmes publikimit të këtij vendimi në ueb faqe dhe platforma të tjera online, në ditën e njëjtë të hyrjes në fuqi të vendimit.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Mbështetur në Rregulloren Nr. 01/2024 për kriteret dhe procedurat e punësimit në KMDK Sh.A., si dhe duke marrë parasysh numrin e kufizuar të aplikimeve të pranuara, me vendim të U.D. Kryeshefes Ekzekutive vazhdohet afati i konkursit publik për pozitën "Urëmatës/Mbikëqyrës i Sektorëve në DS Velekincë" Gjilan, për pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë.

Zgjatja e afatit bëhet me qëllim të rritjes së shikueshmërisë së konkursit, tërheqjes së një numri më të madh të kandidatëve potencialë dhe ofrimit të mundësive shtesë për aplikim, duke nxitur konkurrueshmërinë dhe duke siguruar një proces të hapur dhe transparent të rekrutimit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj pozite në proceset operative të KMDK Sh.A., veçanërisht në pranimin, peshimin dhe evidentimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e sektorëve operativë, si dhe në zbatimin e standardeve të sigurisë dhe higjienës në punë, plotësimi i këtij vendi të punës është i rëndësishëm për funksionimin efikas dhe vazhdimësinë e operimeve në deponinë sanitare.

Duke u bazuar në sa më sipër, është vlerësuar e nevojshme zgjatja e afatit të aplikimit, me qëllim të krijimit të mundësive për përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

Arkivit të KMDK SH.A

Administratës së KMDK SH.A.

Emine Berisha Ferzullahu

U.D. Kryeshefe Ekzekutive e KMDK SH.A